

VENDIM
Nr. 311, datë 30.11.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 161, DATË 17.6.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘VOKOPOLA ENERGJI’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et ‘VOKOPOLA 1’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 274 kw, ‘VOKOPOLA 2’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3104 kw, DHE ‘VOKOPOLA 3’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2297 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 5675 kw”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1999/8 prot., datë 30.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s n. 161, datë 17.6.2022 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Vokopola Energji’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et ‘Vokopola 1’, me kapacitet të instaluar 274 kw, ‘Vokopola 2’, me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe ‘Vokopola 3’, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 161, datë 17.6.2022 ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Vokopola Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kw, “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw, për një afat 25 vjet e 8 muaj.

2. Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. të depozitojë brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit:

- a) vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj;
- b) licencën për drejtuesin teknik elektrik, për HEC-et “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”;
- c) kontratat e qirave për zonën ku do të shtrihet projekti të rinovuara, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në këtë zonë;
- d) dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare që mbulojnë vlerën e investimit për për HEC-et “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”.

3. Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k., të depozitojë lejen për përdorimin e burimit ujor për HEC “Vokopola 1” përpara fillimit të operimit të këtij HEC-i.

Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 161/2022, ka përcjellë dokumentacionin si më poshtë:

- Në plotësim të pikës 2, germa “a”, të vendimit të licencimit nr. 161/2022, shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. ka përcjellë në ERE: vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të datës 23.11.2022, nga i cili rezulton se shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. nuk rezulton të ketë procedim penal në ngarkim të saj dhe vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për administratorin e shoqërisë, të datës 23.11.2022, nga i cili nuk rezulton të ketë procedim penal në ngarkim të tij.

- Në plotësim të pikës 2, germa “b”, të vendimit të licencimit nr. 161/2022, shoqëria ka depozituar në ERE licencën nr. K.0719/4 të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për inxhinierin hidroteknik dhe licencën nr. N.6457/3 lëshuar nga MIE për shoqërinë “Engineering-Systems” (drejtues ligjor dhe teknik), që do t’i shërbejnë ndjekjes së punimeve, për HEC-et “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”.

- Në plotësim të pikës 3 të vendimit të licencimit nr. 161/2022, shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k., ka depozituar lejen për përdorimin e burimit ujor për HEC “Vokopola 1”, me nr. 496 prot., datë 7.7.2022, të miratuar nga Këshilli i Basenit Ujor Seman me nr. 1, datë 30.6.2022,

lëshuar për subjektin “Vokopola Energji” për HEC “Vokopola 1”, e cila ka afat vlefshmërie sipas kontratës së koncesionit.

· Nga gjithë sa më sipër në vijim të plotësimeve të bëra nga shoqëria, si dhe dokumenteve që mbeten pa plotësuar, vlerësohet që vendimi nr. 161/2022 të ndryshojë si vijon:

Pika 2 e vendimit nr. 161/2022, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. të depozitojë brenda 30 ditëve nga marrja dijani e vendimit:

- a) vërtetimet e gjykatës për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj;
- b) kontratat e qirave për zonën ku do të shtrihet projekti të rinovuara, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në këtë zonë;
- c) dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare që mbulojnë vlerën e investimit për për HEC-et “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”.”.

Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 161/2022, shfuqizohet.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimi i tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 161/2022 ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. të depozitojë brenda 30 ditëve nga marrja dijani e vendimit:

- a) vërtetimet e gjykatës për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj;
- b) kontratat e qirave për zonën ku do të shtrihet projekti të rinovuara, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në këtë zonë;
- c) dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare që mbulojnë vlerën e investimit për HEC-et “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”.

2. Të shfuqizojë pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.6.2022 “Mbi licencimin e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kw, “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kW, dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti